



*Të përfitojmë
nga begatitë
e muajit
Ramazan*

*Të përfitojmë nga begatitë
e muajit Ramazan*



Përgatiti:

QENDRA KULTURORE FETARE “UDHA E BESIMTARËVE”

Boton:

QENDRA KULTURORE FETARE “UDHA E BESIMTARËVE”

Rr. Kajo Karafili, Pll. 8, Shk. 1, Ap. 12, Tiranë, Albania

Tel.: +35542247064, Mob.: +355693565505,

+355672567863

e-mail: info@udhaebesimtareve.com

www.udhaebesimtareve.com

Tryeza e lëndës

Parathënie	5
1. Lutju Allahut që ta arrish muajin e Ramazanit dhe të përfitosh bereqetin e tij!	9
2. Agjëro gjatë ditëve të Ramazanit!	10
3- Lexoje Kuranin, librin e Allahut!	11
4- Kushtoi rëndësi faljes së namazit të teravive	15
Sa rekate falet namazi i teravive?	16
Falja e teravive me xhemat	17
5- Shtoje bujarinë në këtë muaj të begatë!	18
6- Qëndrimi në xhami për adhurim, në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit!	21
7- Nëse mundesh, planifiko një Umre në Ramazan!	23
8-Shfrytëzoje natën e Kadrit!	25
Çfarë e bën natën e Kadrit një natë kaq të veçantë?	26
Kur është kjo natë?	27
Çfarë duhet të bëjë muslimani për të arritur mirësitë e natës së Kadrit?	28
Disa shenja të natës së Kadrit	29
9- Jepe sadakanë e Fitrit!	31
Kur duhet dhënë sadakaja e Fitrit?	31
Kush e ka detyrë ta japë sadakanë e Fitrit?	32
Cilat janë llojet e ushqimeve që jepen për sadaka-Fitri?	32
10- Gëzohu ditën e Fitër Bajramit!	34





بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut,

të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit

Parathënie

Muslimanët gëzohen dhe lumturohen me ardhjen e muajit të madhërishëm të Ramazanit. Kjo ndodh, sepse Ramazani është muaji i mëshirës, muaji i faljes, muaji i agjërimit, muaji i Kuranit, muaji i përkushtimit, muaji i begativate të shumta...

Në muajin e Ramazanit ka zbritur Kur'ani famëmadh. Në këtë muaj hapen dyert e xhennetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë. Në këtë muaj pranohen lutjet dhe lirohen njerëzit nga zjarri. Në këtë muaj është nata e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Allahu i Madhëruar e ka veçuar këtë muaj me adhurimin e agjërimit, vepër e cila është më e mira, më e vlefshmja dhe është ajo vepër që të afron më shumë tek Allahu i Madhëruar.

Profeti ﷺ i përgëzonte besimtarët me ardhjen e këtij muaji të begatë duke thënë:

“U erdhi Ramazani, muaji i begatë. Allahu ua ka obliguar agjërimin e këtij muaji. Në të hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë më agresivë. Në këtë muaj gjendet një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Ai që privohet nga mirësitë e kësaj nate, është vërtetë i privuar.”¹

Begatitë dhe mirësitë e këtij muaji janë të shumta. Në këtë muaj besimtarët përjetojnë ndjesitë më të mrekullueshme të besimit të tyre. Gjatë këtij muaji ndërthuren më së miri adhurimet me njëra-tjetrën, të tilla siç janë: agjërimi, leximi i Kuranit, falja e namazit të teravive, shtimi i lutjeve, shpeshtimi i përmendjes së Zotit, dhënia e sadakasë, ofrimi i ushqimit për nevojtarët etj...

Secili nga muslimanët shpreson që të përfitojë sa më shumë nga mirësitë dhe begatitë e këtij muaji të madhërisëm, si dhe do të dëshironte

¹ Transmeton Imam Ahmedi në El Musned me nr. 8979, Nesaiu me nr. 2106 etj. E ka saktësuar Albani në Sahihu et Tergib uet Terhib 1/490.

ta përmbyllte atë duke depozituar shpërblime (sevape) të shumta.

Nisur nga kjo, natyrshëm lind pyetja: Si të përfitojmë nga begatitë e muajit të Ramazanit?

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë të përvijuar qartë në Librin e Allahut të Madhëruar si dhe në porosinë e Profetit ﷺ. Në to gjejmë një larmi veprash dhe adhurimesh me të cilat besimtari duhet të angazhohet gjatë muajit të Ramazanit, në mënyrë që të përfitojë sa më shumë prej mirësive dhe begative të tij.

Një tjetër faktor ndihmës në këtë drejtim është dhe njohja me mënyrën praktike se si besimtarët e dalluar të të gjitha kohërave, duke filluar që me brezin e artë të sahabëve dhe ata që erdhën pas tyre, e përjetonin këtë muaj të madhërishëm.

Angazhimi dhe përkushtimi që ata tregonin gjatë muajit të Ramazanit, duhet të na shërbejë si motivues për të ripërtërirë vullnetin dhe për të shtuar ambiciet tona për vjeljen e fryteve të këtij muaji.

*Duke u nisur nga sa thamë
më lartë, le të rendisim
disa nga adhurimet më
të rëndësishme me të cilat
besimtari dhe besimtarja,
duhet të angazhohen gjatë
muajit të Ramazanit:*

1. Lutju Allahut që ta arrish muajin e Ramazanit dhe të përfitosh bereqetin e tij!

Të parët tanë të mirë (selefët) i luteshin Allahut që ta arrinin muajin e Ramazanit dhe t'u mundësohej që të përfitonin sa më shumë prej mirësive të tij. Ata luteshin duke thënë:

“Allahumme sel-limni li-ramadane ue sel-lim ramadane lij ue tesel-lemhu min-ni mutekab-belen!”

“O Allah më mundëso mua që ta arrij muajin e Ramazanit, më mundëso që ta shfrytëzoj atë duke bërë vepra të mira dhe pranoji ato!”²

Muslimani i lutet Allahut të Madhëruar, që t'i japë ndihmë dhe sukses për arritjen e mirësive dhe begative, kjo sepse vetëm me mirësitë dhe dhuntitë e Tij bëhet i mundur realizimi i veprave të mira.

Profeti ﷺ ka thënë: **“Kushtoji rëndësi punëve të mira që të bëjnë dobi! Gjithnjë kërkoi ndihmë Allahut dhe mos u dorëzo!”**³

² E transmeton Taberani dhe Ebu Nuajmi, nga Jahja bin ebi Kethiri.

³ E transmeton Muslimi me nr. 2664.

2. Agjëro gjatë ditëve të Ramazanit!

Agjërimi i ditëve të muajit të Ramazanit është adhurim madhështor, është një nga obligimet më të rëndësishme në jetën e muslimanit, madje është njëra ndër pesë shtyllat bazë të fesë.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Islami ngrihet mbi pesë shtylla: ...,-e njëra ndër to është, - Agjërimi i muajit të Ramazanit.”**⁴

Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëlartë thotë:

“O ju që keni besuar! Agjërimi u është bërë obligim, ashtu siç ishte obligim edhe për popujt para jush, me qëllim që të jeni të devotshëm.” (Bekare 183).

Agjërimi i muajit të Ramazanit është një nga veprat më të mira, që të afron tek Zoti i Madhëruar.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush e agjëron Ramazanin duke besuar, e duke shpresuar shpërblimin, i falen mëkatet që i ka bërë më herët”**⁵

⁴ E transmeton Buhariu me nr. 8 dhe Muslimi me nr. 16.

⁵ E transmeton Buhariu me nr. 38 dhe Muslimi me nr. 760.

Vërejtje:

Që agjërimi i besimtarit të jetë sa më i begatë preferohet që t'i kushtohet rëndësi ngrënies së syfyrit dhe lutjes, të cilën agjëruesi bën në kohën e iftarit. Profeti ﷺ ka thënë: **“Ushqehuni në syfyr, sepse në të ka bereqet!”**⁶

Gjithashtu ka thënë: **“Syfyri është ushqim i begatë, prandaj mos e lini atë, edhe sikur me një gllënjë ujë, sepse Allahu i bekon ata që hanë syfyr dhe engjëjt lutën për ta.”**⁷

Kur afrohet koha e çeljes së iftarit është e pëlqyeshme që muslimani ta shfrytëzojë për t'u lutur, sepse lutja në atë kohë është e pranueshme nga Allahu i Lartësuar.

Profeti ﷺ ka thënë: **“Tre kategorive nuk u kthehen lutjet mbrapsht: Prijësit të drejtë, agjëruesit kur çel iftarin dhe lutja e atij të cilit i është bërë padrejtësi.”**⁸

⁶ E transmeton Buhariu me nr. 1923 dhe Muslimi me nr. 1905.

⁷ E transmeton Ahmedi në “El-Musned” 3/44, El-Mundhiri në “Et-Tergib” 2/139. Albani e ka konsideruar hadith të mirë në librin “Sahihu et Tergib” me nr. 1070.

⁸ E transmeton Tirmidhiu me nr. 2525. Albani e ka konsideruar hadith të saktë në librin “Sahihu et Tirmidhi” me nr. 2050.

Përveç lutjeve të ndryshme që muslimani mund të bëjë në këtë kohë të begatë, gjithashtu preferohet të thotë dhe lutjen të cilën na e ka mësuar Profeti ﷺ në lidhje me çeljen e iftarit:

“Dhehebe dhameu, ue bteletil uruku, ue thebetel exhru insha Allah

-U largua etja, u njomën venat dhe u depozitua shpërblimi, në dashtë Allahu!”⁹

⁹ Transmeton Ebu Daudi në “Sunenin” e tij me nr. 2357. Albani e ka vlerësuar hadith të mirë në librin “Sahihu Ebi Daud” me nr. 2066.

3- Lexoje Kuranin, librin e Allahut!

Kurani është fjala e Allahut, e zbritur në muajin e Ramazanit, në Natën e Kadrit, e cila është në dhjetë netët e fundit të Ramazanit. Allahu i Madhëruar thotë:

“Muaji Ramazan është ai në të cilin ka zbritur Kurani...” (Bekare, 185)

Gjithashtu ka thënë:

“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.” (Kadër, 1)

Çdo herë në muajin e Ramazanit, profeti Muhamed ﷺ e përsëriste Kuranin famëmadh dhe e studionte atë së bashku me engjëllin Xhibril a.s, ndërsa në vitin e fundit të jetës së tij, ata e përsëritën Kuranin dy herë.

Për të përfituar sa më shumë nga bereqeti i këtij muaji kërkohet një përkushtim i veçantë ndaj Kuranit. Agjëruesi duhet të lexojë sa më shumë Kur'an, duke ndërthurur ndërmjet agjërimit dhe leximit të Kuranit, këtyre dy adhurimeve madhështore të cilat ia gjallërojnë atij jetën shpirtërore.

Kurani gjatë muajit të Ramazanit është kënaqësi dhe freski për shpirtin dhe bëhet shkak për rritjen e besimit. Leximi i Kuranit gjatë muajit të Ramazanit shpërblehet me sevape të shumta. I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush lexon një shkronjë nga Libri i Allahut fiton një sevap (shpërblim) dhe ky sevap i shumëfishohet dhjetëfish.”**¹⁰

Në Ditën e Gjykimit, Kurani do të ndërmjetësojë për lexuesin e tij. I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Lexojeni Kuranin, sepse në Ditën e Gjykimit, ai vjen si ndërmjetësues për ata që e lexojnë atë.”**¹¹

Gjithashtu ai ka thënë: **“Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë për njeriun në Ditën e Gjykimit. Agjërimi do të thojë: O Zot! E kam privuar nga ushqimi dhe pija, prandaj më lejo që të ndërmjetësoj për të! Ndërsa Kurani do të thojë: E kam privuar nga gjumi i natës, prandaj më lejo që të ndërmjetësoj për të! Kështu që ata të dy do të ndërmjetësojnë.”**¹²

¹⁰ E transmeton Tirmidhiu me nr. 2910. Albani e ka vlerësuar si hadith të mirë në “Silsiletu es Sahiha” 2/267.

¹¹ E transmeton Muslimi me nr. 1343

¹² E transmeton Ahmed i me nr. 6589. Albani e ka vlerësuar si

4- Kushtoi rëndësi faljes së namazit të teravive

Namazi i teravive, është namazi i natës i cili kryhet gjatë muajit të Ramazanit. Fjala “teravi” është shumësi i fjalës “teruihatun” e cila rrjedh nga fjala “rahatun”, që do të thotë çlodhje, pushim. Është emërtuar kështu ngaqë gjatë faljes së këtij namazi bëhet një pushim i shkurtër pas çdo katër-rekatësh.

Ky namaz vullnetar është nga veprat më të mira që kryhen gjatë këtij muaji të begatë, si për meshkujt ashtu edhe për femrat.

Ebu Hurejra r.a. tregon se Profeti ﷺ i nxiste njerëzit për t’u falur gjatë natës në Ramazan, por jo në mënyrë të detyrueshme.

Ai thoshte: **“Kush falet gjatë netëve të Ramazanit me besim dhe duke shpresuar shpërblimin, do t’i falen mëkatet që i ka bërë më herët.”**¹³

hadith të saktë në “Sahihul Xhami” me nr. 7329.

¹³ E transmeton Buhariu me nr. 37 dhe Muslimi me nr. 759.

Ibn Battali, komentuesi i njohur i haditheve thotë:

“Me besim” d.m.th.: Duke besuar në mirësinë që Allahu i Madhëruar i ka caktuar kësaj vepre.

“Duke shpresuar shpërblimin” d.m.th.: Duke e bërë këtë vepër me qëllimin për të merituar shpërblimin e Allahut.

Sa rekate falet namazi i teravive?

Ebu Seleme bin Abdurrahman bin Aufi, tregon se e ka pyetur Aishen: Si ka qenë namazi i Profetit ﷺ në Ramazan?

Ajo tha: **“Profeti ﷺ, si në muajin e Ramazanit ashtu dhe në muajt e tjerë, nuk falte (namaz nate) më tepër se njëmbëdhjetë rekate. Ai falte katër rekate dhe mos pyet për bukurinë dhe gjatësinë e tyre, pastaj falte katër rekate të tjera dhe mos pyet për bukurinë dhe gjatësinë e tyre, pastaj falte tre rekate”**¹⁴

Ky hadith orienton dhe argumenton më së miri në lidhje me këtë çështje. Kjo për tre arsye:

¹⁴ E transmeton Buhariu me nr. 3569 dhe Muslimi me nr. 738.

- 1- Është hadithi më i saktë në lidhje me këtë çështje, sepse transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi.
- 2- Është hadithi më i qartë, i cili i vë një kufi sasior këtij namazi.
- 3- Është hadithi që tregon për praktikën profetike, ndërkohë që transmetimet e tjera tregojnë vepra të sahabëve apo të tabi'inëve.

Falja e teravive me xhemat

Planifikoje që namazin e teravive ta falësh në xhami me xhematin, pasi në këtë mënyrë arrin ta ndjesh më tepër ëmbëlsinë dhe kënaqësinë e këtij adhurimi, si dhe do të shpërblehesh më shumë sesa po të falesh vetëm.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush falet natën (gjatë Ramazanit) me imamin derisa ai ta përfundojë namazin, do t’i shkruhet shpërblimi sikur të ketë falur namaz tërë natën.”**¹⁵

¹⁵ E transmeton Tirmidhiu me nr. 806 dhe Nesaiu me nr. 1605. Albani e ka konsideruar hadith të saktë në “Sahihu et Tirmidhi” me nr. 734.

5- Shtojë bujarinë në këtë muaj të begatë!

Bujaria është traditë profetike, moral i njerëzve fisnikë dhe cilësi e besimtarëve të mirë.

Muaji i Ramazanit është padyshim “stina” e shpalosjes së bujarisë.

Muslimani në këtë muaj duhet të jetë më bujar se në muajt e tjerë të vitit, duke marrë si shëmbëlltyrë të Dërguarin e Allahut ﷺ, për të cilin Ibën Abasi tregon duke thënë:

“I Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeriu më bujar, dhe kulmin e bujarisë së tij e shfaqte në Ramazan, muaj në të cilin takohej me Xhibrilin. Ai takohej me të çdo natë të Ramazanit, duke e studiuar së bashku Kuranin. Në Ramazan, i Dërguari i Allahut ishte më i shpejtë në bujari sesa era kur fryn”.¹⁶

Bujaria në Ramazan mund të shprehet në disa forma:

a. Duke dhënë sadaka

S’ka dyshim se pasuria që njeriu ka, një ditë do të mbarojë e do të zhduket, ndërsa çfarë depozitohet tek Allahu, është e garantuar dhe e

¹⁶ E transmeton Buhariu me nr. 411 dhe Muslimi me nr. 2308.

shumëfishuar. Prandaj mos u trego koprrac ndaj vetes tënde, por garo në fitimin e sevapeve, duke dhënë nga ajo pasuri që Allahu të ka dhuruar. Allahu i Madhëruar, thotë: **“Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, atë do ta gjeni tek Allahu”** (Bekare, 110)

Ndërsa në hadithin kudsij, Allahu i Madhëruar thotë:

“O biri i Ademit! Jep që të të jap!”¹⁷ Profeti ﷺ ka thënë: **“Kush jep sadaka sa vlera e një kokrre hurme nga fitimi i tij i pastër — e s’ka dyshim që Allahu pranon vetëm çfarë është e pastër - Allahu ia pranon atë me të djathtën e Tij dhe e shumëfishon për llogari të atij që e dha”**¹⁸

b. Nxjerrja e Zekatit

Nxjerrja e zekatit është ndër obligimet e rëndësishme në Islam, madje një nga pesë shtyllat e tij.

Preferohet që nxjerrja e këtij obligimi pasuror të bëhet në muajin e Ramazanit në mënyrë që të përfitohet sa më shumë nga shpërblimet dhe begatitë e këtij muaji.

¹⁷ E transmeton Buhariu me nr. 5037 dhe Muslimi me nr. 993.

¹⁸ E transmeton Buhariu me nr. 1410 dhe Muslimi me nr. 1014.

Uthmani (r.a) ka thënë: “Ky (Ramazani) është muaji i nxjerrjes së zekatit tuaj. Kush i ka borxh dikujt le t’ia shlyejë në mënyrë që ai të japë zekatin e pasurisë së tij.”¹⁹

c. Duke ushqyer agjëruesit.

Dhënia ushqim agjëruesit është një vepër e begatë, shpërblimi i së cilës është i madh. Profeti ﷺ ka thënë:

“Kush i ofron ushqim agjëruesit, do ta ketë shpërblimin njësoj si ai, pa u pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit.”²⁰

Shtrimi i iftareve për agjëruesit është traditë dhe praktikë e lavdëruar e muslimanëve.

Dijetari i mirënjohur Ibn Shihab Ez-Zuhri thoshte: **“Gjatë muajit të Ramazanit spikasin dy adhurime: Leximi i Kuranit dhe ofrimi i ushqimit për agjëruesit.”**

¹⁹ E transmeton Imam Maliku 1/253, Imam Shafiu 1/237 etj. Albani e ka konsideruar këtë transmetim ‘të saktë’ në “Irvaul galil” 3/260.

²⁰ E transmeton Tirmidhiu me nr. 807, Nesaiu 2/256 etj. Albani e ka konsideruar hadith të saktë në “Sahihul Xhami” me nr. 6415.

6- Qëndrimi në xhami për adhurim, në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit!

Qëndrimi në xhami për ibadet apo 'itikafi' është vepër e pëlqyeshme në Ramazan, të cilën e ka përmendur Allahu në Kuran në ajetet të cilat trajtojnë temën e agjërimit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe mos kini raporte intime me gratë gjatë kohës së qëndrimit në xhami për itikaf”**. (Bekare, 187)

Ibnul Kajimi në lidhje me qëllimin dhe urtësitë e itikafit ka thënë: “Thelbi i itikafit është veçimi i njeriut duke iu përkushtuar adhurimit të Zotit, duke u shkëputur nga rutina dhe aktivitetet e tij të përditshme, në mënyrë që preokupimi i tij i vetëm në ato ditë të begata të jetë përmendja e Zotit, madhërimi i Tij, përgjërimi tek Ai, shtimi i dashurisë për Të, duke e zbrazur zemrën nga preokupimet dhe angazhimet e kësaj bote kalimtare”.

Itikafi në Ramazan është prej traditës profetike. Aisheja —radiallahu anha- tregon se: **“Profeti ﷺ ka bërë itikaf në çdo dhjetë ditësh të fundit të Ramazanit, derisa ndërroi jetë”**.²¹

²¹ E transmeton Buhariu me nr. 1922 dhe Muslimi me nr. 1172.

Muslimani i cili vendos të qëndrojë në xhami për adhurim (itikaf) duhet t'i përmbahet disa normave dhe dispozitave.

Siç është përmendur dhe më sipër, itikafi është një formë specifike e përkushtimit në adhurim, që kryhet vetëm në xhami. Aisheja —radiallahu anha- thotë: **“Itikafi nuk bëhet askund tjetër përveçse në ato xhami në të cilat kryhen rregullisht faljet e namazit me xhemat”**²²

Gjithashtu një normë tjetër e rëndësishme e itikafit është qëndrimi në xhami gjatë gjithë periudhës së itikafit, duke mos dalë prej saj veçse për arsye domosdoshmërie. Aisheja —radiallahu anha- thotë: **“Tradita profetike në lidhje me itikafin është: Ngujimi në xhami dhe mos dalja prej saj, veçse për nevoja të domosdoshme.”**²³

²² E transmeton Ebu Daudi me nr. 2473, Bejhakiu në el Kubra 4/321. Albani e ka konsideruar këtë transmetim ‘të saktë’ në libërthin “Kijamu Ramadan” fq 27.

²³ Burimi i mësipërm

7- Nëse mundesh, planifiko një Umre në Ramazan!

Umreja është vizita e Qabes, me qëllim kryerjen e adhurimeve specifike të cilat janë pjesë e këtij rituali.²⁴

Vizita e faltores së lashtë, Qabes, është një ndër adhurimet të cilat lënë mbresa të pashlyeshme në zemrën e muslimanit dhe ripërtërijnë ndjenjat e besimit. Kjo për shkak se Qabeja është faltorja e parë në Tokë, e ngritur si vend adhurimi për Allahun e Madhëruar.

Janë transmetuar hadithe të shumta të cilat tregojnë për vlerën dhe mirësinë e kryerjes së Umres në muajin e Ramazanit.

Profeti ﷺ thotë: **“Kur të hyjë muaji i Ramazanit, bëj një Umre, se Umreja në Ramazan është e barasvlershme me një haxh”**.²⁵

²⁴ Umreja dallon nga Haxhi në disa aspekte. Dy më kryesoret janë: a) Umreja mund të kryhet në çdo periudhë të vitit, ndërsa Haxhi kryhet vetëm në një periudhë specifike, në muajin hënor Dhul Hixheh. b) Umreja ka më pak rituale adhurimi se sa Haxhi, si për nga lloji ashtu dhe në sasi.

²⁵ E transmeton Buhariu me nr. 1690 dhe Muslimi me nr. 1256.

Në një hadith tjetër përcillet se Profeti ﷺ ka thënë:
“Një Umre në Ramazan është e barabartë me
një Haxh me mua”.²⁶

²⁶ E transmeton Buhariu me nr. 1764 dhe Muslimi me nr. 3098.

8-Shfrytëzoje natën e Kadrit!

Një nga begatitë më të mëdha të Ramazanit padyshim është nata e Kadrit, e cila gjendet në njërën nga dhjetë netët e fundit të këtij muaji. Kjo natë është një mundësi e madhe për t'u afruar më tepër tek Zoti, për të shtuar shpërblimet, si dhe për t'u pastruar nga mëkatet dhe gabimet. Nga tradita profetike në dhjetë ditë-netët e fundit të Ramazanit është që muslimani të jetë më aktiv në adhurime se në çdo periudhë tjetër.

I Dërguari i Allahut ﷺ kur fillonte dhjetëshi i fundit i Ramazanit, përkushtohej në adhurime, e gjallëronte natën; falej, lutej, lexonte Kur'an. Madje, nga tradita profetike është dhe nxitja e pjestarëve të familjes që të përfitojnë edhe ata nga begatitë e këtyre netëve, veçanërisht e natës së Kadrit, e cila është më e vlefshme se njëmijë muaj.

Aisheja, radiallahu anha, rrëfen për të Dërguarin e Allahut duke thënë: **“Profeti ﷺ, në dhjetë ditë-netët e fundit të Ramazanit, angazhohej me adhurime dhe vepra të mira, më shumë se çdo herë tjetër”.**²⁷

²⁷ E transmeton Buhariu me nr. 1920

“Ai i gjallëronte netët me adhurim, madje i zgjonte anëtarët e familjes së tij (që ta adhuronin Allahun), dhe i dedikojë tërësisht adhurimit”.²⁸

Çfarë e bën natën e Kadrit një natë kaq të veçantë?

Vlera e natës së Kadrit shpaloset në katër veçori madhështore:

1- Në të ka zbritur Kurani. Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) në natën e Kadrit”** (Kadr, 1). Në një ajet tjetër thotë: **“Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) në një natë të begatë”** (Dukhan, 3)

2- Shpërblimet e veprave të mira shumëfishohen si asnjëherë tjetër, duke e bërë këtë natë më të vlefshme se një mijë muaj adhurim. Allahu i Lartësuar në Kuran thotë: **“Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.”** (Kadr, 3)

3- Në këtë natë, engjëjt me në krye engjëllin Xhibril a.s, zbresin me vendimet hyjnore për çdo gjë që do të ndodhë në Tokë për një vit. Allahu i Madhëruar thotë: **“Engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) zbresin natën e Kadrit me caktimin e çdo gjëje (për vitin).”** (Kadr, 4).

²⁸ E transmeton Muslimi me nr. 1175

Ebu Hurejra —radiallahu anhu- transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: **“Engjëjt atë natë janë më të shumtë sesa numri i guralecëve në Tokë”**.²⁹

4- Kush e kalon këtë natë duke u falur dhe duke adhuruar Zotin, i falen të gjitha gjynahet e kaluara. Profeti ﷺ ka thënë: **“Kush e përjeton natën e Kadrit me adhurim ndaj Zotit, me besim të sinqertë dhe duke shpresuar shpërblimin, do t'i falen mëkatet që i ka bërë më herët.”**³⁰

Kur është kjo natë?

Nata e Kadrit është njëra nga dhjetë netët e fundit të Ramazanit.

Aisheja —radiallahu anha- transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: **“Kërkojeni natën e Kadrit në netët teke të dhjetëshes së fundit të Ramazanit!”**³¹

²⁹ Transmetohet tek Musnedi i Ahmedit me nr. 10734, Ibn Huzejmeh me nr. 2194. Albani e ka vlerësuar si hadith të mirë në “Silsiletu es Sahiha” me nr. 2205.

³⁰ E transmeton Buhariu me nr. 35 dhe Muslimi me nr. 760.

³¹ E transmeton Buhariu me nr. 1913

Çfarë duhet të bëjë muslimani për të arritur mirësitë e natës së Kadrit?

Për të arritur mirësitë dhe begatitë e kësaj nate, muslimani duhet të fokusohet në dy adhurime:

a. Të shtojë namazin e natës.

Profeti ﷺ ka thënë: **“Kush e përjeton natën e Kadrit me adhurim ndaj Zotit, me besim të sinqertë dhe duke shpresuar shpërblimin, do t’i falen mëkatet që i ka bërë më herët.”**³²

b. Të shtojë lutjet.

Duke qenë se nata e Kadrit është ajo natë në të cilën zbresin vendimet hyjnore për vitin në vijim, kjo e bën atë një mundësi të mirë për njeriun që t’i lutet Zotit që gjatë atij viti t’i japë nga të mirat e Tij të panumërta dhe ta mbrojë nga të këqijat.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar lutjes të cilën Profeti ﷺ na e ka mësuar enkas për këtë natë. Aisheja —radiallahu anha— tregon se e ka pyetur Profetin ﷺ: O i Dërguari i Allahut! Nëse do ta dija se kur është nata e Kadrit çfarë lutje të them? Ai e mësoi të thotë:

³² E transmeton Buhariu me nr. 35 dhe Muslimi me nr. 760.

“Allahume ineke afu’un tuhibul afue fe`afu ani!”³³

O Zot, Ti je Mëkatfalës, e do faljen, prandaj më fal mua!

Disa shenja të natës së Kadrit.

1- Ajo është një natë e qetë, jo e nxehtë dhe as e ftohtë.

Xhabir bin Abdullahu —radiallahu anhu- tregon se Profeti ﷺ ka thënë: **“Ajo është një natë e qetë, e shndritshme, as e nxehtë dhe as e ftohtë”**.³⁴

2- Në agimin e ditës së nesërme dielli lind i zbehtë, pa vezullimin e zakonshëm.

³³ E transmeton Tirmidhiu me nr. 3513, Ibn Maxheh me nr. 3113, etj. Hadithi është vlerësuar i saktë nga Neveviu në el Edhkar me nr. 247, Ibnul Kajjimi në l’lamul muveki’in 4/249 dhe Albani në “Sahihu Tirmidhi” me nr. 3513.

³⁴ E transmeton Ibn Huzejmeh 3/330, Ibn Hibani në Sahih me nr. 3680, Tajalisiu në Musnedin e tij me nr. 3680, etj. Hadithi është vlerësuar i saktë nga Albani në “Sahihul Xhami” me nr. 5475.

Ubej bin Kabi —radiallahu anhu- tregon se Profeti ﷺ ka thënë: “**Në agimin vijues dielli lind pa rreze** (pa vezullimin e zakonshëm)”.³⁵

³⁵ E transmeton Muslimi me nr. 762

9- Jepe sadakanë e Fitrit!

Në fund të Ramazanit, agjëruesi për ta përmbyllur në mënyrë sa më të përsosur këtë muaj të begatë, obligohet me dhënien e sadakasë së Fitrit; një sasi ushqimore për të varfërit.

Ibn Abasi —radiallahu anhumu- thotë: **“Profeti ﷺ e ka bërë detyrë për çdo musliman dhënien e sadakasë së Fitrit, si pastrim për agjëruesin prej lëshimeve që mund të ketë bërë dhe fjalëve të pahijshme që mund të ketë thënë, si dhe që të shërbejë si ushqim për të varfërit.”**³⁶

Ndër urtësitë e kësaj dispozite është dhe shfaqja e solidaritetit me njerëzit në nevojë, duke kontribuar sadopak që ata të kenë një arsye më shumë që të gëzojnë në ditën e festës së Fitër Bajramit.

Kur duhet dhënë sadakaja e Fitrit?

Koha e dhënies së sadakasë së Fitrit fillon me perëndimin e diellit të ditës së fundit të Ramazanit, e cila është nata e bajramit. Ndërsa caku i mbarimit është koha e namazit të Bajramit.

³⁶ E transmeton Ebu Daudi me nr. 1609, Ibn Maxhe me nr. 1827, etj. Hadithi është vlerësuar i mirë nga Albani në “Sahihu ebi Daud” me nr. 1420.

Mirëpo nëse agjëruesi për arsye të ndryshme, e ka të vështirë dhënien e kësaj sadakaje, në kohën e lartpërmendur, atëherë i lejohet që ta japë atë një ose dy ditë para mbarimit të muajit të Ramazanit, ashtu siç vepronte sahabiu i nderuar Ibn Omeri —radiallahu anhu- i cili e jepte sadakanë e Fitrit një ose dy ditë para Bajramit.³⁷

Kush e ka detyrë ta japë sadakanë e Fitrit?

Sadakaja e Fitrit është detyrë për çdo person musliman i cili i ka mundësitë që ta japë këtë sadaka. Kryefamiljari duhet të japë për veten dhe të gjithë anëtarët e familjes. Ibn Omeri -radiallahu anhu- ka thënë: **“Profeti ﷺ ka obliguar që sadakaja e Fitrit të jepet për çdokënd nga muslimanët, qoftë ai rob apo i lirë, mashkull apo femër, i vogël apo i madh”**.³⁸

Cilat janë llojet e ushqimeve që jepen për sadaka-Fitri?

Duhet të dimë se llojet e ushqimeve që janë të vlefshme për t`u dhënë sadaka e Fitrit janë ushqimet bazë të cilat konsumohen nga banorët

³⁷ Shiko Sahihun e Buhariut tek nr. 1440.

³⁸ E transmeton Buhariu me nr. 1433 dhe Muslimi me nr. 984.

e atij vendi. Në kohën e Profetit ﷺ ushqimet bazë ishin: gruri, elbi, hurma arabe, qumështi pluhur, rrushi i thatë, etj.

Në kohën tonë ushqimet bazë janë: orizi, makaronat, mielli, fasulja, etj.

Sasia e ushqimit që duhet të jepet për çdo individ të familjes është përafërsisht 2.4 kg.

10- Gëzohu ditën e Fitër Bajramit!

Dita e Fitër Bajramit është ditë gëzimi, në të cilën besimtari i gëzohet mirësive të Allahut, si dhe faktit që e përmbushi me sukses obligimin e agjërimit dhe kryerjen e veprave të mira gjatë muajit të Ramazanit.

Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: **“Plotësojini ditët e agjërimit, e pastaj madhërojeni Allahun për suksesin e dhënë, që të jeni falënderues!”** (Bekare 185).

Profeti ﷺ ka thënë: **“Çdo popull ka festat e veta, ndërsa kjo është festa jonë.”³⁹**

Dijetari i madh Ibën Haxheri ka thënë: "Prej dobive që përftohen nga ky hadith është fakti se preferohet shtimi i shpenzimeve për familjen gjatë festave të Bajrameve (në blerjen e ndonjë dhurate, apo ushqimeve të preferuara), në mënyrë që të futësh kënaqësi në zemrat e tyre.... Shfaqja e gëzimit dhe lumturisë gjatë dy festave të Bajrameve, është prej simboleve të fesë."⁴⁰
Në ditën e festës së Bajramit kërkohet kryerja e disa veprave të cilat e përmbyllin në mënyrën

³⁹ E transmeton Buhariu me nr. 949 dhe Muslimi me nr. 792.

⁴⁰ "Fet'hul Bari" vëll. 2, f. 443.

më të mirë përfitimin e begative të muajit të Ramazanit. Ndër to veçojmë:

a. Të lahemi, të parfumosemi dhe të vishemi sa më bukur.

Dita e Bajramit është ditë feste dhe është prej traditës profetike zbukurimi në ditë feste.

Ibnul Kajimi ka thënë: "Është transmetuar se i Dërguari i Allahut ﷺ vishte rrobat më të bukura në ditët e festave. Ai kishte një xhybe të veçantë të cilën e vishte në festat e Bajrameve dhe ditëve të Premte."⁴¹

Imam Maliku ka thënë: "Kam dëgjuar shumë prej dijetarëve ta konsiderojnë të pëlqyeshme parfumosjen dhe të zbukuruarit në ditët e Bajrameve."

b. Pjesmarrja kolektive në faljen e namazit të Bajramit.

Veçori dhe simbolikë e Festës së Bajramit është pjesmarrja e të gjithëve në gëzimin dhe mirësinë që përcjell kjo ditë. Kjo manifestohet që sa zbardh

⁴¹ "Zadul Mead" vëll. 1, f. 441.

dita, me pjesmarrjen në namazin e Bajramit, i cili preferohet të kryhet në një vend të hapur, në mënyrë që pjesmarrja të jetë sa më e madhe.

Të gjithë muslimanët që kanë mundësi, duhet të marrin pjesë në faljen e namazit të Bajramit, madje është e pëlqyeshme që të jenë të pranishme edhe gratë të cilat nuk falen për shkak të periodave. Ato megjithëse nuk falen, është mirë që të jenë pjesmarrëse në tubimin e ditës së Bajramit për të përfituar prej mirësisë së kësaj dite dhe lutjes së muslimanëve.

Ummu Atije -radiallahu anha- ka thënë: **“Profeti ﷺ na ka porositur që të dalim në ditën e Bajramit, madje ka porositur që të dalin vashat si dhe gratë me perioda”.**⁴²

c. Ta madhërojmë Allahun gjatë shkuarjes për në vendin e faljes, derisa të fillojë namazi i Bajramit.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Plotësojini ditët e agjërimit, e pastaj madhërojeni Allahun për suksesin e dhënë, që të jeni falënderues!”**
(Bekare 185).

⁴² E transmeton Buhariu me nr. 324 dhe Muslimi me nr. 890.

“I Dërguari i Allahut ﷺ e madhëronte Allahun me tekbir gjatë shkuarjes për tek faltorja e namazit të Bajramit (namazgjaja). Ai vazhdonte me tekbire deri sa të vinte koha e faljes.”⁴³

Thënia e tekbireve në ditën e Bajramit mund të bëhet në disa mënyra, ashtu siç transmetohet nga disa prej sahabëve.

Ibn Mesudi -radiallahu anhu- në ditët e Bajramit thoshte këtë tekbir: **"Allahu ekber, Allahu ekber, La ilahe il-lallah, ue Allahu ekber, Allahu ekber, ue lil-lahil hamd."**⁴⁴

Ibën Abasi -radiallahu anhu- thoshte: **"Allahu ekber, Allahu ekber. Allahu ekber ue lil-lahil hamd. Allahu ekber ue Exhel, Allahu ekber ala ma hedana."**⁴⁵

⁴³ "Silsiletul ehadithi es sahiha" me nr. 170.

⁴⁴ E ka transmetuar Ibën ebi Shejbe vëll. 2, f. 168, me zinxhir transmetimi të saktë. "Irvaul galil" 3/125.

⁴⁵ E ka transmetuar El Bejhekij vëll. 3, f. 315. Zinxhirin e transmetimit e ka të saktë "Irvaul galil" 3/126.

Abdurrazaku ka përcjellë nga Selman el Farisiu -radiallahu anhu-, se ai ka thënë: "**Madhërojeni Allahun duke thënë: Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekberu kebiran.**"⁴⁶

e. Të dëgjojmë këshillën e imamit

Preferohet dëgjimi i këshillave të imamit pas faljes së namazit të Bajramit.

Transmetohet nga Ebu Seid El Hudri -radiallahu anhu- se ai ka thënë: "I Dërguari i Allahut ﷺ ditën e Fitër Bajramit dhe Kurban Bajramit dilte për në faltore, dhe gjëja e parë që bënte ishte falja e namazit, pastaj kthehej me fytyrë nga njerëzit dhe predikonte duke i këshilluar dhe porositur, ndërsa ata qëndronin ulur në vendet e tyre dhe e dëgjonin."⁴⁷

f. Të urojmë njëri-tjetrit për pranimin e punëve të mira.

Ashtu siç e paraprimë këtë muaj të begatë me lutje që Allahu të na japë nga mirësitë dhe

⁴⁶ El Bejhekiç në librin "Es Sunenu El Kubra" vëll. 3, f. 316. Ibën Haxheri në "Fet'hul Bari" 2/462 ka thënë: Ky është transmetimi më i saktë që përcillet në lidhje me mënyrën e thënies së tekbireve.

⁴⁷ E transmeton Buhariu me nr. 956 dhe Muslimi me nr. 889.

begatitë e tij, po ashtu e përcjellim atë duke iu lutur Allahut që të na i pranojë adhurimet që kemi bërë.

Lutju Allahut për vete dhe të tjerët dhe uroji muslimanët me pranimin e veprave të mira!

Xhubejr bin Nufejri tregon: “Shokët e Profetit ﷺ kur takoheshin në ditën e Bajramit e uronin njëri-tjetrin duke thënë: *"Tekab-belallahu mina ue minkum! - Allahu na i pranoftë punët e mira neve dhe juve!"*

*Lusim Allahun e Madhëruar
që të na mundësojë
të përfitojmë sa më shumë
nga mirësitë dhe begatitë e muajit
të madhërishëm të Ramazanit!*

Amin!

